


“KOSMONTE FOODS” SH.P.K.

Rr.Antenave, p.n. Harilaq, Fushe Kosovë



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR THERTOREN E SHPEZËVE - PULAVE, ME INVESTITOR “KOSMONTE FOODS” SH.P.K. HARILAQ, KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Fushë Kosovë, Korrik – 2025

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR THERTOREN E SHPEZËVE - PULAVE

Parcela nr. 00025-1, Zona kadastrale Harilaq, Komuna Fushë Kosovë

	EMRI	HARTUESE E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
Aplikuesi	Lulzim Begaj	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Investitori:	“KOSMONTE FOODS” SH.P.K.	
Adresa:	Rr. Antenave, p.n. Harilaq, Fushë Kosovë.	Glllogoc (Drenas)
Lokacioni i Fabrikës	Harilaq, Rruga e Pejës ne afërsi të Rrugës Magjistrale Prishtinë - Pejë	
Tel:	+383 38 733 377	+383 49 588 634
Email:	info@kosmontefoods.com	Blerinabajraktari1@gmail.com Blerinabajraktari3@gmail.com

Nënshkrimi dhe Vula

Nënshkrimi

Fushë Kosovë, Korrik - 2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	1
1.1	Për Kompaninë.....	2
1.2	Thertorja e shpezëve - Pulave	2
a)	Vendndodhja e Projektit	3
b)	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit.....	6
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	10
d)	Përshkrimi Detal i Procesit Teknologjik dhe Prodhimi Final.....	11
e)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit.....	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	3
3.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME	4
4.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	5
4.1	Hidrografia.....	6
4.2	Ndryshimet natyrore	7
5.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	8
5.1	Ndikimet në ajër.....	8
5.2	Ndikimet në tokë.....	9
5.3	Ndikimet në ujë.....	9
5.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	10
5.5	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	10
5.6	Ndikimet nga zhurma.....	11
5.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	12
5.8	Ndikimet në Pasuritë Materiale.....	12
5.9	Ndikimet në Trashëgimin Kulturore	12
5.10	Ndikimet Mjedisore nga Mbeturinat.....	12
6.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	13
7.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	14
8.	PËRSHKRIMI I MASAVE	16
8.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	16
8.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	17
8.3	Masat për mbrojtje nga zhurma	18
8.4	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	19
8.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	19
8.6	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	20

8.7	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	20
8.8	Menaxhimi i mbeturinave	21
9.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE.....	22
10.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	23
11.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	24
12.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE.....	25
13.	LITERATURA E PERDORUR.....	26

Lista e Figurave:

Figura 1	Projekti Konceptual i Fabrikës së Thertore i planifikuar për Ndërtim nga "Kosmonte Foods" Sh.p.k., Harilaq Fushë Kosovë.....	3
Figura 2	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë "Kosmonte Foods" Sh.p.k.	4
Figura 3	Lokacioni i planifikuar për ndërtimin e Thertores për shpezë.....	4
Figura 4.	Raporti i distancës së Thertores me shtëpi banimi dhe biznese tjera.....	5
Figura 5	Ortofoto dhe Harta topografike e parcelës ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë	6
Figura 6	Situacioni i Fabrikës së thertores dhe perpunimit të mishit e planifikuar për ndërtim nga Kompania Kosmonte Foods Sh.p.k.....	6
Figura 7	Objekti në të cilin do të vendosen makineritë e thertores.....	7
Figura 8	Objekti ku janë të vendosura makineritë për Ndarjen e mishit nga kockat perpunimi dhe paketimi	8
Figura 9	Situacioni i Fabrikës së Planifikuar për ndërtim nga "Kosmonte Foods" Sh.p.k.	9
Figura 10	Prerja tërthore e objektit të fabrikës së planifikuar për ndërtim nga “Kosmonte Foods” Sh.p.k.	10
Figura 12.	Procesi teknologjik i Punës së thertores	13
Figura 13	Rrjeti Hidrografik i Komunës së Fushë Kosovës	6
Figura 14	Model Impianti për trajtimin e ujerave të ndotura kapaciteti ditor i trajtimit 30 m ³	18

Lista e Tabelave:

Tabela 1	Vlerat maksimale, minimale dhe mesatare të rrjedhës së ujit ($Q=m^3/s$) në stacionin.....	6
Tabela 2	Burimet e ujit në Komunën e Fushë Kosovës	7
Tabela 3	Kufizimet e Nivelit të lejuar të Zhurmes sipas Hartes zonale të komunes së Fushe Kosoves.....	19

1. HYRJE

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është hartuar me qëllim të identifikimit, vlerësimit dhe propozimit të masave mbrojtëse për ndikimet potenciale që dalin nga veprimtaria e thertores nga kompania “KOSMOTE FOODS” SH.P.K.. me Lokacion në Harilaq, Komuna e Fushë Kosovës.

Ky raport përbën një komponent thelbësor në procesin e pajisjes me Pëlqim Mjedisor, sipas kërkesave të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke qenë dokumenti bazë për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për operimin e aktivitetit në përputhje me kornizën ligjore mjedisore.

Qëllimi i këtij raporti është që të paraqesë në mënyrë të qartë, të argumentuar dhe transparente ndikimet që mund të rezultojnë nga aktiviteti i therjes së shpezëve, përfshirë edhe veprimtaritë ndihmëse si:

- Therjen e kafshëve,
- Përpunimin dhe konservimin e mishit, si dhe
- veprimtaritë ndihmëse si transporti, ruajtja, trajtimi i mbetjeve dhe deponimi i nënprodukteve.

Analiza e ndikimeve është realizuar mbi bazën e gjendjes ekzistuese në terren, karakteristikave fizike dhe mjedisore të lokacionit, si dhe dokumentacionit teknik dhe ndërtimor të objektit.

Ky raport ka për detyrë që:

- Të identifikojë burimet potenciale të ndotjes gjatë ndërtimit dhe operimit;
- Të vlerësojë ndikimet e tyre mbi komponentët e mjedisit si: ajri, uji, toka, biodiversiteti, zhurma dhe peizazhi;
- Si dhe të propozojë masa të përshtatshme mbrojtëse për eliminimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative, duke siguruar përputhje me standardet ligjore dhe ekologjike.

Rezultatet e këtij vlerësimi do të shërbejnë si bazë për marrjen e vendimit administrativ për Pëlqimin Mjedisor, pasi kjo është hera e parë që realizohet vlerësimi mjedisor për këtë aktivitet. Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 4. Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis. Objekti i fabrikës është i planifikuar të vendoset në Parcelën me nr. 00025-1, Zona kadastrale Harilaq Komuna Fushë Kosovë, ku prona është në emër të pronarit të kompanisë.

1.1 Për Kompaninë

“KOSMONTE FOODS” SH.P.K. është frymëzuar nga bukuritë e maleve dhe fushave të Kosovës, ku edhe mori emrin ‘Kosmonte Foods’. Duke e zyrtarizuar themelimin e kompanisë në vitin 2000, si një distributor i vogël, dhe sot ne një korporat me disa filiale si, Shqipëri, Gjermani dhe Dubai, me mbi 1000 produkte nga mbi 100 brende të ndryshme, Kosmonte Foods Sh.p.k. sjell produktet të freskëta, duke i dhënë mundësinë konsumatorit të zgjedh në mes të një game të llojllojshme produktesh me origjinë vetëm nga shtetet evropiane, nga furnitor me përvojë mbi 100 vjeçare prodhimi, duke garantuar cilësi dhe siguri në ushqim. Ndër to janë produkte të qumështit, mishit, perimeve, kafe, çaj dhe produkte për gastronomi.

Misioni i kompanisë është që të bëjmë jetën e konsumatorit më të shëndetshme, duke i ofruar përgjegjshmëri, ekselencë, shërbim, gjurmueshmëri dhe fokus në nevojat e konsumatorit.

Vizioni i Kompanisë është që të krijoj besimin tek konsumatori duke qenë kështu zgjidhja më efektive për produktet e tryezës për familjen e tyre.

Përdorimi dhe përditësimi i teknologjisë ka qenë pjesë produktive e kompanisë çdoherë. Kështu duke e implementuar dhe aplikuar atë, i ka mundësuar kompanisë në çdo moment të ketë informata në kohë reale, mbi gjendjen e mallit në depo, të procesoj porositë nga tereni, duke mundësuar përgatitjen e mallrave në kohë të shkurtër porositë e blerësit, liferimin dhe raporte tjera që ndërlidhen me terenin. Të gjitha këto raporte përpunohen në mënyrë elektronike nga departamentet përkatëse duke i mundësuar menaxhmentit dhe klientit bashkëpunim, veprim dhe zgjidhje efikase.

Më 8 Shkurt të vitit 2022, Kosmonte Foods Sh.P.K. mori statusin “Investitor Strategjik” nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky është një nga investimet më serioze në industrinë e ushqimit që do të rrisë prodhimin vendor dhe vendet e punës në Republikën e Kosovës.

1.2 Thertorja e shpezëve - Pulave

Kompania “**Kosmonte Foods**” Sh.p.k., e cila operon në sektorin e përpunimit të ushqimit dhe mishit të shpezëve, aktualisht furnizohet me lëndë të parë nga Sllovenia. Megjithatë, që nga fillimi i këtij viti, janë evidentuar vështirësi në sigurimin e vazhdueshëm të kësaj lënde të parë, gjë që ka krijuar pengesa në furnizimin e tregut me mish pule dhe ka ndikuar negativisht në plotësimin e kërkesave të konsumatorëve.

Si përgjigje ndaj këtyre sfidave dhe me qëllim të sigurimit të një furnizimi të qëndrueshëm me lëndë të parë, kompania ka planifikuar ndërtimin e një **thertoreje moderne për shpezë**. Ky

investim synon të garantojë cilësi të lartë të produktit, furnizim të pandërprerë për konsumatorët, si dhe eliminimin e mungesave dhe vonesave në treg.

Projekti i ndërtimit të thertores do të realizohet në **Zonën Industriale të Harilaqit**, në ngastrën kadastrale nr. **P-72514003-00025-1**, e cila ndodhet brenda territorit administrativ të **Komunës së Fushë Kosovës**.

Thertorja e shpezëve (pulave) është projektuar të ketë një kapacitet ditor prej **4,000–6,000 copë**, duke e pozicionuar atë si një ndër kapacitetet më të mëdha në rajon për këtë lloj aktiviteti. Furnizimi me lëndë të parë do të bëhet fillimisht nga ferma të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Kjo menyr e furnizimit është e përkohshme, pasi kompania ka në plan të zhvillojë fermat e veta për rritjen e pulave, me qëllim të krijimit të një zinxhiri të integruar prodhimi.

Ky projekt konsiderohet me rëndësi strategjike për kompaninë dhe rajonin, për shkak të ndikimeve pozitive në aspektin ekonomik dhe të sigurisë ushqimore, si dhe për krijimin e vendeve të reja të punës.




Figura 1 Projekti Konceptual i Fabrikës së Thertore i planifikuar për Ndërtim nga "Kosmonte Foods" Sh.p.k., Harilaq Fushë Kosovë

a) Vendndodhja e Projektit

Objekti i thertores së shpezëve ndodhet në ngastrën me nr. P-72514003-00025-1, Zona kadastrale Harilaq Komuna Fushë Kosovë. Kompania “Kosmonte Foods” SH.P.K., ndodhet në

territorin administrativ të komunës Fushë Kosovës. Me herët kompania ka filluar ndërtimin e objektit për përpunimin e mishit , dhe tani objektin e thertores do ta bej ngjit me këtë objekt.



Figura 2 Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë "Kosmonte Foods" Sh.p.k.

Lokacioni i planifikuar për ndërtimin e Thertores, gjendet ne një distance prej 11.8 km nga qendra e komunës së Fushe Kosovës.




Figura 3 Lokacioni i planifikuar për ndërtimin e Thertores për shpezë

Afër objektit, ku pritet të ndërtohet thertorja, largësia mes shtëpive të banimit dhe bizneseve tjera, është paraqitur në figurën me poshtë, ku largësi me afërt me shtëpi banimi është mbi 50 m, ndërsa me biznese tjera distanca me e vogël është mbi 80 m.




Figura 4. Raporti i distancës së Thertores me shtëpi banimi dhe biznese tjera




Figura 5 Ortofoto dhe Harta topografike e parcelës ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Përshkrimi i Veçorive Fizike të Projektit të Fabrikës së Thertores së Pulave nga Kompania “Kosmonte Foods” SH.p.k. Duke u bazuar në Projektin Konceptual të Fabrikës së Thertores së Pulave, objekti planifikohet të ndërtohet në formë kaskade, nga materiali beton arme, me një kulum të konstruksionit kapriate me mbuloj sandwich panel, me dimensione e paraqitura si me poshte:




Figura 6 Situacioni i Fabrikes se thertores dhe perpunimit te mishit e planifikuar për ndertim nga Kompania Kosmonte Foods Sh.p.k.

2. Objekti i Përpunimit dhe Paketimit të Mishit, me sipërfaqer: Fper.= 2,095.18 m²




Figura 8 Objekti ku janë të vendosura makinerite për Ndarjen e mishit nga kockat perpunimi dhe paketimi

3. Objekti i Ruajtjes së Mishit të Paketuar dhe Zona e Ngarkimit për Eksport. Me sipërfaqe Fobj.r.= 1,359.82 m²




Figura 9 Situacioni i Fabrikës së Planifikuar për ndërtim nga "Kosmonte Foods" Sh.p.k.




Figura 10 Prerja tërthore e objektit të fabrikës së planifikuar për ndërtim nga “Kosmonte Foods” Sh.p.k.

Nga projekti konceptual, shihet qarte se fabrika e planifikuar për ndërtim është sipas normave dhe standardeve e cila ka të planifikuar shumë hapësira gjelbëruese për rreth objektit dhe po ashtu rrugët janë të projektuara në hyrje dhe dalje që të mos kemi bllokim dhe vonesa të kamionëve dhe makinave në oborrin e kompanisë.

Veprimtaria e thertores dhe perpunimit të mishit nga shpezët (Pulat), parimisht vlerësohet se do të ketë ndikimin minimal në mjedis i cili është i pa përfillshim.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Fabrika e therrjes dhe perpunimit të mishit nga shpezët (Pulat) në Harilaq të Komunës së Fushë Kosovës është në fazën e kompletimit të të gjitha lejeve të nevojshme për ndërtim.

Me poshtë paraqesim përshkrimin e veçorive kryesore të fazës operative të Fabrikës për përpunimin e ushqimit dhe mishit nga shpezët, janë:

- **Objekti i Therrtores**
 - Dhoma e elektrikes,
 - Dhoma e sigurise se punonjësve,
 - Hapesira e therrjes se shpezve
- **Objekti ku behet ndarja dhe Paketimi**
 - Depo për Mallrat MDM

- Dekostimi i Mishit MDM (ose “Pajisja për Dekostimin e Mishit MDM” nëse është ambient/pajisje)
 - Zamrues i Shpejtë -30°C (Shock Freezer)
 - Depo në Temperaturë -18°C
 - Depo në Temperaturë 0–4°C
 - Objekte Ndhmëse për Punonjësit – ZONA E VERDHË
 - Prerja dhe Paketimi.
- **Objekti ku do te ngarkohen maunet per transport:**
 - Larja e Tabakëve – Zona e Pastër
 - Larja e Tabakëve – Zona e Papastër
 - Ekspeditë/Transport
 - Depo në Temperaturë 0–4°C
 - Depo në Temperaturë -18°C
 - Ekspeditë

Sa i përket komponentëve kryesore, për therrtoresh dhe e mishit nga shpezët (Pulat), janë:

- Lënda e parë është mish i shpezëve (Pulat),

Lendet ndihmëse kryesore:

- Energjia elektrike,
- Uji.

d) Përshkrimi Detal i Procesit Teknologjik dhe Prodhimi Final

Procesi i therrjes së shpezëve (Pulave) në një therrtoresh moderne është i projektuar për të garantuar standarde të larta higjienike, mirëqenie të kafshëve dhe cilësi të produktit përfundimtar. Ky proces zhvillohet përmes disa fazave të automatizuara dhe të kontrolluara me pajisje teknologjike moderne:

1. Prani shpezëve (Pulave) – shpezët transportohen në therrtoresh me mjete të dedikuara, për bartje të shpezëve. Pas pranimit, behet trulllosja dhe varja e tyre.
2. Vendosja në linjë të therrjes – Shpezët(pulat) ngrihen në mënyrë të kujdesshme në shiritat e varjes me **krahë mekanike ose manualisht**, duke shmangur lëndimet që mund të shkaktojmë shpezëve. Pas kësaj duhet të qetësohen, ku metodën të cilën do e përdor kompania është , metoda e qetësimit elektrik me ujë, e cila redukton shqetësimet e shpezëve dhe permison mirëqenie e tyre.

3. Therja – shpezët kalojnë në stacionin e therjes automatike ku pritet arteria karotide dhe vena jugulare. Pas therjes , shpezët qëndrojnë për 2-3 minuta për të siguruar heqjen e plotë të gjakut, faktor kyç për cilësinë dhe sigurinë higjienike të mishit.
4. Pastrimi i shpezëve nga pendelave – para largimit të tyre shpezët zhyten në tanka me ujë të ngrohtë në temperaturë **50–60°C për 1.5–3 minuta**, që lehtëson heqjen e pendëve. Heqja e pendave realizohet me makina me gishta gome që heqin pendët pa dëmtuar lëkurën.
5. Heqja e kokës, këmbëve dhe pastrimi - Heqja e kokës dhe këmbëve kryhet automatikisht, Më pas bëhet hapja e zgavrës abdominale dhe nxjerrja e organeve të brendshme, duke pastruar trupin e shpezëve.
6. Kontrolli veterinar dhe inspektimi higjienik – është e obligueshme që të bëhet kontrolli nga veterineri dhe inspektimi higjienik, në mënyrë që të identifikohet ndonjë sëmundje apo ndotje në organet e shpezëve.
7. Larja dhe ftohja - Trupat e shpezëve lahen me ujë të pastër për të larguar çdo mbetje dhe më pas kalojnë në tunelin frigoriferik (air chilling) për ftohje të shpejtë në temperaturë nën 4°C. Kjo fazë është kritike për sigurinë ushqimore dhe ruajtjen e cilësisë së mishit. Trupat e shpezëve lahen me ujë të pastër për të larguar mbetjet dhe mikroorganizmat sipërfaqësorë, pas kësaj bëhet ftohja e cila bëhet në tunel frigoriferik ose me zhytje në ujë të ftohtë (immersion chilling) në temperatura **nën 4°C** për të parandaluar rritjen mikrobiale. Trupat e ftohur mund të ndahen në copa, të pakëtohen ose të magazinohen në depo frigoriferike në pritje të shpërndarjes.

Mbetjet organike dhe ato të tjera (pendë, gjak, pjesë të brendshme) menaxhohen sipas standardeve mjedisore përmes sistemit të mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve. Kompania ka ndarë një dhomë të posaçme për ruajtjen e të gjitha mbetjeve që dalin nga procesi i therjes.

8. Magazinimi dhe shpërndarja - Produktet përfundimtare ruhen në kushte frigoriferike (0–4°C dhe shpërndahen tek pjesa tjetër e kompanisë e cila merret me përpunimin, paketimin e mishit dhe shpërndahen me mjete të certifikuar frigoriferike.




Figura 11. Procesi teknologjik i Punës së thertores

e) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së ndërtimit dhe operimit

Me poshtë do ti përshkruajmë të gjitha emetimet e pritura gjate fazës së ndërtimit dhe gjate operimit:

Uji: Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së ndërtimit nuk do të ndikoj negativisht, por duke u bazuar në masat e marruar nga kompania, nuk do të ndikoj negativisht as gjate fazës së operimit, ndotja është minimale. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për proces teknologjik të pastrimit të shpezëve, makinerive, pastrimit të dyshemesë, nevojat sanitare e higjienike, dhe përpunimit të mishit të shpezëve dhe nuk përdoret për qëllime tjera. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për të gjitha nevojat e kompanisë, pas përdorimit të tij do të shkarkohet impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura pastaj do të shkarkohet në rrjetin e kanalizimit të fshatit. Ndikimi kryesor i ndotjes së ujërave janë shkarkimet e ujërave të pa trajtuara në mungesë të impianteve por në rastin në fjale projektuesi ka parapare trajtimin e ujërave të ndotura nga e gjithë kompania.

Ajri: Ky aktivitet nuk parasheh përdorimin e lëndëve djegëse të dëmshme, nuk parasheh ndonjë proces teknologjik të përpunimit të produkteve industriale apo kimike dhe realisht nuk paraqet potencial për ndikime në kualitetin e ajrit. Ndikime minimale në ajër, ndodhin gjate fazës së ndërtimit brenda parcelës, gjate sjelljes së materialeve ndërtimore të parafabrikuara me kamion si dhe gjate betonimit me lëvizjen e mikserëve por janë ndikime të cilat mund të kontrollohen lehtë. Gjate shkarkimit të shpezëve nga kamionët në objektin e posaçëm për ruajtjen e tyre, mund të kemi ndotje të ajrit por e cila është minimale

Dheu – duke konsideruar kapacitetet e projektuara të thertores, si dhe si rezultat i investimit adekuat – kontakti i ujërave nga brenda lokacionit të projektit me ujërat sipërfaqësore është izoluar - mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën të janë minimale.

Zhurma – gjate ndërtimit e po ashtu edhe gjate operimit mund të ketë zhurmë gjate lëvizjes së makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjate operimit është minimale.

Dridhjet – Dridhjet të tokës - tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje

kanë shkaktuar vetëm shqetësim. Dukuritë tjera, që shpesh ndodhin në territorin e Fushë-Kosovës, janë: rrëshqitja e dheut, akullnajat, breshëri, si dhe dukuri tjera që shkaktajnë dëme në pasuri bujqësore dhe në infrastrukturë.

Drita, nxehtësia dhe rrezatimi – Janë tri dukuri që të trijat së bashku të ndihmojnë në realizimin e punës ku lokacioni ku do të ndërtohet thertorja ka dritë, rrezatim diellor dhe nxehtësi të mire.

Flora dhe Fauna – Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë, pasi që kjo zonë është zonë industriale dhe përreth thertores ka edhe shumë aktivitet tjera.

Ndikimet sociale dhe ekonomike – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqesë ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku Fabrika si fillim do të ketë rreth 40 punëtorë të cilët do të përfitojnë paga dhe mëditje të mira. Ky Projekt pritet të ndikojë pozitivisht në ekonominë vendore dhe lokale.



2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e thertores së shpezët me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Shtojca 4 e këtij ligji:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Për Mbrojtje Nga Zjarri Nr. 08/L-261
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Në kuadër të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), janë analizuar alternativat e mundshme për realizimin e projektit të ndërtimit të thertoresh së shpezëve. Qëllimi i analizës së alternativave është të sigurohet zgjedhja më e përshtatshme për realizimin e projektit, duke marrë parasysh ndikimet mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Alternativat e perzghedhjes:

– Zgjedhja e Zonave Industriale Të Përshtatshme

Kjo alternativë përfshin ndërtimin e thertoresh në Zonën Industriale të Harilaqit, në ngastrën kadastrale nr. P-72514003-00025-1, Komuna Fushë Kosovë. Është e pajisur me infrastrukturë bazë (rrugë, energji elektrike, ujësjellës dhe kanalizim). Ndodhet afër qendrave të konsumit dhe rrjeteve të shpërndarjes, duke reduktuar nevojën për transport të gjatë dhe ndikimet e tij mjedisore. Dhe me e rëndësishmja do të ndërtohet ngjit me fabrikën për përpunimin e mish të cilën është duke e ndërtuar tashme kompania.

– Lokacionet Afër Rrugëve Kryesore dhe Linjave të Transportit

Një mundësi tjetër ishte zgjedhja e një lokacioni që është afër rrugëve kryesore, autostradave, ose hekurudhave, duke siguruar kështu mundësi të shpejta dhe të lirë për transportimin e produkteve dhe lëndëve të para.

– Disponibiliteti i Fuqisë Punëtore Të Kualifikuar

Një faktor tjetër i rëndësishëm në zgjedhjen e lokacionit është mundësia e gjetjes së fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me kosto më të ulëta në krahasim me qytetet më të mëdha. Kjo mund të ndihmojë në uljen e kostove operative dhe në rritjen e efikasitetit të produktit.


– Zonat Me Mundësi Për Zhvillim Afatgjatë

Një tjetër mundësi e shqyrtuar ishte zgjedhja e një lokacioni që ofron mundësi për zgjerim dhe zhvillim afatgjatë. Ky opsion është i rëndësishëm për të siguruar fleksibilitet në rast se kërkesa për produkte rritet dhe nevojitet një rritje e kapaciteteve prodhuese.

4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit është si rezultat i zhvillimit të pakontrolluar në sektorët industrial dhe urban, planifikimit joadekuat të pajisjeve industriale dhe urbane, teknologjisë së vjetër industriale, teknologjisë joadekuate në disa departamente industriale të resurseve natyrore, infrastrukturës joadekuate në qytet, shtimi i numrit të automjeteve, ndotja e rrjedhave të ujit për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, akumulimi i plehrave urbane dhe të ngurta industriale, prerja e pakontrolluar e pyjeve, erozioni i dheut dhe aktivitetet e tjera të njeriut.

Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, duhet të mbrohet nga ndotja e madhe që vjen nga ndotësit lokal por edhe nga ndotësit e mëdhenj në komunat fqinje si Termoelektranat dhe Ferronikeli. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, duhet të mbrohet nga zhvillimi i paplanifikuar, duke respektuar kornizën për zhvillim hapësinor të propozuar me planin zhvillimor, me qëllim të arritjes së shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të pasurive të mjedisit. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, me peizazhin dhe trashëgiminë natyrore paraqet një burim të rëndësishëm për komunën i cili duhet të shfrytëzohet për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit. Monumentet natyrore e kulturore duhet të trajtohen si trashëgimi kombëtare dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme. Vend me potencial turistik paraqet pejsazhi i pyjeve në Sllatinë të Vogël, Harilaq dhe në Bardh të madh.



Po ashtu si vend piktoresk mund do jetë në te ardhmen edhe liqeni i peshqve në Henc. (Burimi: Plani lokal i veprimit në mjedis, 2009).

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja është një prioritet për komunën e Fushë Kosovës duke pasur parasysh shkallën e madhe të ndotjes në vend dhe rajon. Ndotja e ajrit është evidente, dhe përpos trafikut të automjeteve dhe industrisë lokale ndotje të madhe shkaktojnë Termoelektranat në Obiliq si dhe Ferronikeli në Drenas. Po ashtu nga mbetjet e prodhimeve industriale dhe nga mbeturinat ndotet edhe uji në komunën e Fushë Kosovës.

Gjatë dhënies së lejeve për objekte zhvillimore ekonomike, në pajtim me rregullat mjedisore, duhet të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis siç janë ndotja e ajrit dhe zhurma, vibracionet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

4.1 Hidrografia

Resurset kryesore të ujërave sipërfaqësore ne komunën e Fushë Kosovës janë lumenjtë Sitnica, drenica, Graçanka dhe Prishtina. Këta lumenj degëzohen në territorin e kësaj komune. Disa nga përrockat më të rëndësishme që rrjedhin në këtë komunë janë Gjellbazaku dhe Zanoga. Sitnica është lum i njohur në Kosovë dhe është dega kryesore e lumit Ibër.

Tabela 1 Vlerat maksimale, minimale dhe mesatare të rrjedhës së ujit ($Q=m^3/s$) në stacionin

STACIONI	LUMI	Q _{MIN}	Q _{MES}	Q _{MAK}
Nedakovc - Vragoli	Sitnica	0.50	13.62	328




Figura 12 Rrjeti Hidrografik i Komunës së Fushë Kosovës

Ky lum dallohet nga të tjerët jo vetëm për shkak të madhësisë së pellgut (2.861 km^2), por gjithashtu për shkak të rrjedhës ujore ($16.6 \text{ m}^3/s$). Sitnica formohet nga rrjedha Matica me Sazlinë dhe lumi i Shtimes. Këto rrjedha afër fshatit Robovc bashkohen, duke formuar lumin Sitnicë. Nga këtu e deri në vend derdhje në lumin Ibër, afër Mitrovicës rrjedh për afër 90 km. Karakteristika kryesore e këtij lumi është pjerrtësia e ulët. Për këtë edhe kategorizohet si lum fushor. Sitnica dallohet jo vetëm për shkak të rrjedhës së ulët të ujit por edhe për ndryshime të theksuara gjatë vitit. Rrjedhat ujorë janë më të larta gjatë sitnicë së dimrit dhe pranverës, ndërsa gjatë stinës së verës rrjedha e ujit është mjaft e ulët. Në pikën e derdhjes në lumin Ibër rrjedha

e ujit bie deri në 2.35 m/s. Shtrati i lumit Sitnicë nuk është edhe aq stabil. Gjatë vërshimeve, uji nganjëherë mbulon një pjesë të madhe të fushave në pjesën e rrafshët në mes të Lipjanit dhe Mitrovicës, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme. Sitnica i mbledh ujërat e lumenjëve Gadime, Janjevë, Graçankë, Prishtinë, Llap dhe Samadrezhë në anën e djathtë, dhe ato të lumenjve. Drenicë dhe Lushtë në anën e majtë. Në Territorin e Fushë Kosovë është i vendosur edhe një stacion hidrometrik që i takon rrjetit hidrometrik të Kosovës me 22 stacione matëse, të vendosura nga Instituti Hidrometrologjik i Kosovës. Të dhënat nga ky stacion i cili është vendosur në lokacionin Nadakoc – Vragoli tregojnë se sasia maksimale e rrjedhës është 328 m³/s ndërsa ajo minimale 0/50 m³/s.

Momentalisht në komunën e Fushë Kosovës ekzistojnë 21 burime të ujit që shfrytëzohen për prodhimin e ujit të pijshëm. Të gjitha këto sisteme për furnizim me ujë shfrytëzojnë ujërat nëntokësore.

Tabela 2 Burimet e ujit në Komunën e Fushë Kosovës

Burimi	Lloji i burimit	Kapaciteti (l/s)	Prodhim në 2009 (m3)	Menaxh.
Kroni - Kuzmin	12 puse	150 l/s	2,918,508	KUR
Vragoli	6 puse	60 l/s	Fillon në Shtator 2011	KUR
Henc	1 puse	5 l/s	Nuk ka të dhëna	Komuniteti Lokal
Miradi e Ulët	1 pus	20 l/s	Fillimi i punës në qershor 2011	KUR
Kroni i Spahisë - Harilaq	1 pus	5 l/s	Nuk ka të dhëna	Komuniteti Lokal

4.2 Ndryshimet natyrore

Me ndërtimin e fabrikave të ndryshme do të kemi edhe prishje të peizazhit, do të kemi ndotje gjatë ndërtimit në suaza të caktuara si dhe do të ketë ndryshim të atij lokacioni, sepse shtohet një ndërtim i ri ku kemi rritje të sasisë së ujërave të shkarkuara nga procesi teknologjik si dhe nga lëvizja e makinerive por duke e krahasuar me atë se lëvizja e makinave në rrugë magjistrale bene ndotje me të madhe se sa fabrika e përpunimit të produkteve ushqimore dhe mishit të shpezëve, atëherë gazrat ose pikja e vajit në raste të ndonjë prishje, janë shumë të vogla në krahasim me ndotjen e cila ndodh në magjistrale, dhe se ndikimet janë minimale në mjedis.

Vlen të theksohet se edhe mbeturinat komunale bëjnë ndotje të madhe në ambient dhe natyrë. Sa i përket projektit të fabrikës së përpunimit të ushqimeve dhe mishit nga shpezët nuk ka fare ndikim në ambient sepse nuk shkarkohet ndonjë kemikat apo ndonjë substance që mund të ndotë ujin apo dheun, po ashtu nga funksionimi i fabrikës nuk lirohen gazra.

Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimtarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial, mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve, vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që i rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit dhe ujit, zhurma).

5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ky kapitull paraqet analizën e ndikimeve potenciale mjedisore që mund të shkaktojë ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve të planifikuar në Zonën Industriale të Harilaqit. Vlerësimi përfshin fazat e ndërtimit, operimit dhe fazën pas-operimit, duke marrë parasysh komponentët kryesorë të mjedisit: ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin, peizazhin dhe popullatën.

5.1 Ndikimet në ajër

Ndërtimi dhe operimi i thertores së planifikuar mund të shkaktojë ndikime në cilësinë e ajrit si rezultat i aktiviteteve ndërtimore, përdorimit të pajisjeve dhe proceseve teknologjike gjatë operimit. Gjatë fazës së ndërtimit, pritet emetim i pluhurit (PM10 dhe PM2.5) nga punimet në terren, gërmimet, lëvizja e automjeteve ndërtimore dhe transporti i materialeve. Gjithashtu, përdorimi i makinerive me motorë me djegie të brendshme do të kontribuojë në emetimet e gazeve ndotëse si oksidet e azotit (NOx), monoksidi i karbonit (CO) dhe dioksidi i karbonit (CO₂). Këto ndikime janë të përkohshme dhe të lokalizuara, të cilat mund të minimizohen me zbatimin e masave mbrojtëse si spërkatja e sipërfaqeve me ujë, përdorimi i mjeteve me standarde të larta të emetimeve dhe planifikimi i punimeve gjatë periudhave me lagështi të mjaftueshme për të reduktuar përhapjen e pluhurit.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet kryesore në ajër lidhen me erërat e pakëndshme që mund të gjenerohen nga procesi i thërjes së shpezëve, përpunimi i mbetjeve organike dhe ujërat teknologjike. Gjenerimi i këtyre erërave është i lidhur kryesisht me fazat e qetësimit, thërjes dhe trajtimit të mbetjeve të brendshme (organet, gjaku dhe pendët). Për të minimizuar këto ndikime, thertorja është projektuar me sisteme moderne të ventilimit, biofiltra dhe pajisje për trajtimin e ajrit që mund të reduktojnë ndjeshëm emetimin e erërave jashtë objektit. Po ashtu, menaxhimi i mbetjeve organike në kohë reale dhe përdorimi i teknologjive të mbyllura për trajtimin e tyre ndihmojnë në eliminimin e burimeve potenciale të erërave. Ndikimet nga trafiku gjatë operimit janë të kufizuara dhe të përqendruara kryesisht në rrugët hyrëse dhe dalëse nga objekti, të shkaktuara nga transporti i shpezëve dhe produkteve të përpunuara. Megjithatë, duke marrë parasysh që thertorja ndodhet në një zonë industriale me infrastrukturë të përshtatshme rrugore dhe distancë të mjaftueshme nga zonat e banuara, ndikimet mbi

cilësinë e ajrit janë të konsiderueshme të moderuara dhe të menaxhueshme me masa të përshtatshme.

5.2 Ndikimet në tokë

Ndërtimi dhe operimi i thertores së planifikuar mund të shkaktojë ndikime në cilësinë dhe përdorimin e tokës, të cilat kryesisht lidhen me ndërhyrjet gjatë fazës së ndërtimit dhe menaxhimit e mbetjeve gjatë fazës së operimit. Gjatë ndërtimit, punimet gërmuese dhe niveluese mund të shkaktojnë humbje të përkohshme të mbulesës së tokës dhe ndryshime në strukturën sipërfaqësore, duke rritur rrezikun e erozionit lokal dhe shkarkimeve të sedimentit në ujërat përreth. Përdorimi i makinerive të rënda mund të rezultojë në ngjeshjen e tokës, gjë që mund të ndikojë në aftësinë e saj për të infiltruar ujërat sipërfaqësore. Për më tepër, ekziston rreziku i ndotjes së tokës nga derdhjet aksidentale të naftës, vajrave dhe lëndëve të tjera ndihmëse të përdorura në proceset ndërtimore.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet kryesore në tokë janë të lidhura me menaxhimin e mbetjeve organike dhe ujërave teknologjike. Mbetjet e ngurta si pendët, organet dhe gjaku, nëse nuk trajtohen në mënyrë të duhur, mund të krijojnë rrezik për ndotjen e tokës përmes rrjedhjeve ose deponimit të pakontrolluar. Gjithashtu, ujërat e ndotura teknologjike, nëse nuk filtrohen dhe trajtohen para shkarkimit, mund të përmbajnë ngarkesa të larta organike dhe mikrobiale që mund të depërtojnë në tokë dhe të ndotin shtresat sipërfaqësore ose nëntokësore.

Megjithatë, me projektimin e thertores moderne që përfshin sisteme të mbyllura për trajtimin e mbetjeve dhe ujërave, si dhe me zbatimin e masave mbrojtëse, pritet që ndikimet negative në tokë të jenë minimale dhe të menaxhueshme.

5.3 Ndikimet në ujë

Ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve mund të shkaktojë ndikime në burimet ujore, kryesisht përmes përdorimit të ujit dhe krijimit të ujërave të ndotura. Gjatë fazës së ndërtimit, rreziku për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të lindë nga rrjedhjet aksidentale të derivateve të naftës dhe lëndëve të tjera ndihmëse që përdoren nga makineritë e rënda. Shkarkimi i ujërave të shiut nga sipërfaqet e hapura dhe të paqëndrueshme mund të transportojë sedimente dhe ndotës të tjerë në ujërat përreth.

Gjatë fazës së operimit, thertorja do të ketë një konsum të konsiderueshëm të ujit për proceset teknologjike, pastrimin e pajisjeve dhe sipërfaqeve, si dhe për ftohjen. Si rezultat, gjenerohen ujëra të ndotura që përmbajnë ngarkesa të larta organike (gjak, yndyra, mbetje proteike), baktere dhe përbërës të tjerë që mund të përbëjnë rrezik për mjedisin ujor nëse shkarkohen pa

trajtim adekuat. Për të minimizuar këtë rrezik, projekti parashikon ndërtimin e një sistemi të brendshëm për trajtimin paraprak të ujërave teknologjike, i cili do të përfshijë grumbullimin, filtrimin mekanik, dhe trajtimin biologjik ose kimik para shkarkimit në rrjetin publik të kanalizimit ose në mjedis.

5.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve në Zonën Industriale të Harilaqit parashikohet të ketë ndikime minimale mbi peizazhin, florën dhe faunën për shkak të vendndodhjes së zgjedhur. Lokacioni i projektit ndodhet në një zonë të kategorizuar si zonë industriale sipas dokumenteve planifikuese hapësinore të Komunës së Fushë Kosovës, e cila tashmë karakterizohet nga ndërtime dhe aktivitete të ngjashme industriale. Prandaj, ndërhyrjet ndërtimore nuk do të shkaktojnë transformime të mëdha vizuale në peizazh, pasi objekti i thertores do të përshtatet me strukturat ekzistuese dhe do të ndërtohet me dizajn arkitektonik dhe hapësira të gjelbra përreth për të zbutur ndikimin estetik.

Sa i përket florës dhe faunës, zona ku do të zhvillohet projekti nuk përfshin habitate natyrore, zona të mbrojtura ose lloje të mbrojtura me ligj sipas Udhëzimeve Administrative për mbrojtjen e biodiversitetit në Kosovë. Flora përreth përbëhet kryesisht nga bimësi dhe elementë të vegjël barishtorë që nuk kanë vlera të veçanta ekologjike. Gjithashtu, fauna lokale është e kufizuar për shkak të aktivitetit të vazhdueshëm njerëzor dhe mungesës së habitatit të përshtatshëm. Ndikimet e mundshme mbi faunën mund të përfshijnë vetëm shqetësime të përkohshme gjatë fazës së ndërtimit për shkak të zhurmës dhe pranisë së mjeteve të rënda, të cilat janë të përkohshme dhe zhduken pas përfundimit të punimeve.

5.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve në Zonën Industriale të Harilaqit pritet të ketë ndikime të kufizuara dhe të menaxhueshme mbi vendbanimet dhe popullatën përreth. Lokacioni i zgjedhur ndodhet në një zonë të dedikuar për aktivitete industriale, me një distancë të konsiderueshme nga zonat e banuara, çka redukton potencialin për ndikime të drejtpërdrejta mbi komunitetin lokal.

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimet mbi popullatën përreth mund të shfaqen kryesisht në formën e zhurmës së përkohshme nga aktivitetet e ndërtimit, qarkullimi i automjeteve të rënda dhe mundësia për rritjen e pluhurit në ajër. Megjithatë, këto ndikime janë të përkohshme dhe mund të minimizohen me masa të tilla si planifikimi i punimeve gjatë orarit të ditës, spërkatja e

sipërfaqeve me ujë për kontrollin e pluhurit dhe përdorimi i pajisjeve ndërtimore me standarde të avancuara për kontrollin e emetimeve dhe zhurmës.

Në fazën e operimit, ndikimet kryesore potenciale mbi popullatën lidhen me gjenerimin e erërave të pakëndshme dhe rritjen e trafikut të automjeteve për transportin e shpezëve dhe produkteve të përpunuara. Për të adresuar këto çështje, projekti parashikon instalimin e sistemeve moderne të filtrimit dhe ventilimit për reduktimin e erërave, si dhe organizimin e qarkullimit të automjeteve në mënyrë që të shmanget mbingarkesa në rrjetin rrugor lokal.

Në aspektin social dhe ekonomik, projekti pritet të ketë ndikime pozitive, duke përfshirë krijimin e vendeve të reja të punës për komunitetin lokal, rritjen e aktivitetit ekonomik në zonë dhe përmirësimin e sigurisë ushqimore përmes sigurimit të një furnizimi të qëndrueshëm me mish shpezësh.

5.6 Ndikimet nga zhurma

Gjatë fazës së ndërtimit, burimet kryesore të zhurmës përfshijnë përdorimin e makinerive të rënda ndërtimore, transportin e materialeve dhe punimet e tjera ndërtimore që mund të gjenerojnë nivele të larta të zhurmës mbi kufijtë e lejuar, sidomos nëse punimet kryhen në afërsi të zonave të banuara. Megjithatë, lokacioni i projektit është i pozicionuar në një zonë industriale me distancë të konsiderueshme nga vendbanimet, gjë që ndihmon në amortizimin e efektit të zhurmës tek komuniteti lokal. Për të minimizuar këto ndikime, rekomandohet planifikimi i aktiviteteve ndërtimore gjatë orarit të ditës dhe përdorimi i pajisjeve me nivele të ulëta zhurme që përmbushin standardet e BE-së për emetimet akustike.

Gjatë fazës së operimit, burimet kryesore të zhurmës lidhen me funksionimin e pajisjeve teknologjike të thertores dhe qarkullimin e automjeteve për transportin e shpezëve dhe produkteve të përpunuara. Pajisjet si kompresorët, ventilatorët dhe sistemet e ftohjes mund të kontribuojnë në rritjen e nivelit të zhurmës në ambientin përreth objektit. Për këtë arsye, projekti përfshin përdorimin e pajisjeve me izolim akustik dhe instalimin e barrierave të zhurmës ose gjelbërimeve përreth perimetrit të objektit për të reduktuar përhapjen e valëve zanore jashtë kufijve të thertores. Gjithashtu, mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve teknologjike dhe kontrolli i trafikut në zonën e hyrjes-daljes do të ndihmojnë në minimizimin e zhurmës së gjeneruar gjatë operimit.

5.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve në thertoren e “Kosmonite Foods” Sh.p.k., vlerësohen si raste të izoluar. Nuk ka aktivitete me materiale të rrezikshme të cilat paraqesin potencial të lartë për rrezikimin e shëndetit të njeriut apo mjedisit në përgjithësi.

5.8 Ndikimet në Pasuritë Materiale

Ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve në Zonën Industriale të Harilaqit nuk parashikohet të ketë ndikime të drejtpërdrejta mbi pasuritë materiale ekzistuese në zonën përreth, pasi lokacioni i projektit është i pozicionuar në një zonë të destinuar për aktivitete industriale, e pajisur me infrastrukturë rrugore dhe utilitare të përshtatshme. Ndërtimi i objektit nuk kërkon zhvendosjen e pronave private apo të infrastrukturës publike, dhe nuk ndërhyr në asete materiale si rrugë, ura, linja të energjisë ose objekte të tjera me rëndësi për komunitetin lokal..

5.9 Ndikimet në Trashëgimin Kulturore

Sipas të dhënave ekzistuese hapësinore dhe konsultimeve paraprake me institucionet përkatëse, në ngastrën kadastrale ku do të ndërtohet objekti nuk janë identifikuar asete arkeologjike apo struktura historike që mund të preken drejtpërdrejt ose tërthorazi nga aktivitetet e projektit. Në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi, gjatë fazës së ndërtimit do të aplikohet një regjim monitorimi dhe raportimi për çdo gjetje të mundshme arkeologjike aksidentale. Nëse gjatë punimeve ndërtimore hasen objekte ose struktura me vlera historike, punimet do të ndërpriten menjëherë në zonën përkatëse dhe do të njoftohen autoritetet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për të marrë masa të mëtejshme.

Duke pasur parasysh këto konsiderata dhe masat mbrojtëse, ndikimet potenciale mbi trashëgiminë kulturore vlerësohen si të papërfillshme.

5.10 Ndikimet Mjedisore nga Mbeturinat

Ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve parashikohet të gjenerojë sasi të konsiderueshme të mbeturinave të ndryshme, të cilat, nëse nuk menaxhohen në mënyrë të duhur, mund të shkaktojnë ndikime negative në komponentët kryesorë të mjedisit si toka, uji dhe ajri.

Gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat kryesore përbëhen nga materiale inerte (mbetje betoni, dheu i tepërt, druri, plastika dhe metalet), të cilat kanë potencial për ndotje vizuale dhe kontaminim të tokës nëse deponohen në mënyrë të pakontrolluar.

Në fazën e operimit, thertorja do të prodhojë mbetje organike dhe të ngurta që përfshijnë pendët, gjakun, organet e brendshme, dhe mbeturina të tjera të kafshëve. Këto mbetje, për shkak të natyrës së tyre biologjike, mund të shkaktojnë erëra të pakëndshme, ndotje mikrobiale

dhe tërheqje të insekteve ose kafshëve të egra, duke krijuar rrezik për shëndetin publik dhe ndotjen e ajrit dhe tokës. Po ashtu, ujërat e ndotura teknologjike që përmbajnë mbetje organike kanë potencial të lartë ndotës nëse shkarkohen pa trajtim adekuat.

Kompani ak parapare marrveshjet me kompani për marrjen e ketyre mbeturinave.

Në përgjithësi, me zbatimin e masave të propozuara për menaxhimin e mbeturinave, ndikimet mjedisore konsiderohen minimale dhe të menaxhueshme.

6. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve pritet të ketë pasoja të kufizuara në mjedis, të cilat me zbatimin e masave lehtësuese dhe teknologjive moderne do të jenë të menaxhueshme dhe minimale.

Ajri: Pajoja më të mëdha mund të shkaktohen nga emetimet e pluhurit dhe gazeve gjatë ndërtimit dhe erërat e pakëndshme gjatë operimit. Instalimi i sistemeve të filtrimit dhe menaxhimi i mbetjeve do të eliminojnë rrezikun e ndotjes së ajrit.

Toka: Rreziku kryesor lidhet me ndotjen potenciale nga mbetjet organike dhe derdhjet aksidentale. Sistemet për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve do të parandalojnë ndikimet negative në cilësinë e tokës.

Uji: Ujërat e ndotura teknologjike mund të përbëjnë rrezik për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Trajtimi paraprak i ujërave brenda objektit do të sigurojë që shkarkimet të jenë brenda kufijve të lejuar ligjorë.

Peizazhi, flora dhe fauna: Ndikimet janë minimale për shkak të vendndodhjes së objektit në një zonë industriale dhe mungesës së habitateve natyrore. Gjithashtu, dizajni arkitektonik dhe gjelbërimi do të integrojnë objektin në peizazh.

Popullata dhe vendbanimet: Ndikimet e përkohshme nga zhurma dhe trafiku gjatë ndërtimit janë të menaxhueshme. Në fazën e operimit, ndikimet do të jenë të ulëta për shkak të distancës nga zonat e banuara dhe përdorimit të teknologjive moderne për kontrollin e erërave dhe zhurmës.

Zhurma: Burimet e zhurmës gjatë ndërtimit dhe operimit do të kufizohen përmes planifikimit të orarit të punës dhe pajisjeve të izoluara akustikisht.

Trashëgimia kulturore dhe pasuritë materiale: Nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta për shkak të mungesës së aseteve të mbrojtura në zonën e projektit.

Mbeturinat: Mbetjet organike dhe joorganike do të menaxhohen sipas një plani të integruar për të shmangur ndotjen e ajrit, tokës dhe ujit, duke garantuar riciklimin ose përpunimin e tyre.

Në përgjithësi, me zbatimin e masave të propozuara, pasojat mjedisore të projektit konsiderohen të ulëta dhe nuk pritet të kenë ndikime të pakthyeshme ose të konsiderueshme në mjedisin përreth.

7. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat e përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore janë mbështetur në një qasje sistematike dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë **Sistemin e Menaxhimit Mjedisor (SMM)** si një metodë kryesore. Ky sistem është konceptuar për të ofruar një trajtim të strukturuar dhe të qëndrueshëm të çështjeve mjedisore brenda organizatës, duke siguruar që vendimmarrja dhe praktikatat operacionale të jenë në përputhje me objektivat e mbrojtjes së mjedisit.

Sistemi i Menaxhimit Mjedisor përforcon menaxhimin e përgjithshëm të organizatës duke nxitur një qasje proaktive dhe të integruar në adresimin e aspekteve mjedisore. Në vend të një reagimi të vonuar ndaj problematikave ose sfidave të paparashikuara, SMM promovon planifikimin dhe parandalimin, duke kontribuar në përmirësimin e performancës mjedisore dhe të asaj organizative në tërësi. Për organizatat që tashmë kanë sisteme të forta menaxhimi, integrimi i SMM rrit efikasitetin, ndërsa në organizatat e tjera, ai shërben si bazë për zhvillimin e një menaxhimi më të mirë.

Përfitimet kryesore të zbatimit të SMM në vlerësimin mjedisor:

Kursime në kosto: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor kërkojnë praktika për e ndotjes, të cilat shpesh sjellin kursime financiare përmes përmirësimeve të proceseve ose investimeve të vogla në teknologji efikase. Në vendet evropiane, tarifat për shkarkimet e ujërave të ndotura dhe depozitimin e mbeturinave janë shpesh më të larta se kostoja e masave parandaluese, duke nxitur organizatat të investojnë në reduktimin e ndotjes. Po ashtu, teknologjitë për rritjen e efikasitetit energjetik, si sistemet e ndriçimit dhe pajisjet me konsum të ulët energjie, krijojnë kursime të konsiderueshme.

Zvogëlimi i rrezikut: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor lehtëson menaxhimin e rreziqeve mjedisore që lidhen me emetimet e papranueshme, aksidentet ose detyrimet ligjore. Shqyrtimi fillestar mjedisor dhe plani i veprimit që rrjedh prej tij ofrojnë mjetet për identifikimin dhe reduktimin e mundësisë së ndodhjes së ngjarjeve negative dhe ndikimeve të tyre.

Përputhje me legjislacionin: Në një mjedis gjithnjë e më të rregulluar ligjërish, pajtueshmëria me legjislacionin mjedisor është thelbësore për të shmangur sanksionet dhe për të mbrojtur reputacionin e organizatës. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor mbështet identifikimin e kërkesave ligjore, monitorimin e zbatimit dhe garanton përputhshmëri të vazhdueshme, duke përmirësuar gjithashtu marrëdhëniet me autoritetet publike.

Marrëdhënie më të mira me publikun e gjerë: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor kontribuon në ndërtimin e besimit të komunitetit dhe palëve të interesuara përmes transparencës dhe komunikimit efektiv. Certifikimi dhe raportimi periodik i performancës mjedisore janë mjete që rrisin kredibilitetin e organizatës në raport me publikun.

Përmirësimi i motivimit të punonjësve: Një nga rezultatet më të paparashikuara në anketat e organizatave që kanë zbatuar Sistemet e Menaxhimit Mjedisor është përmirësimi i motivimit të punonjësve. Punonjësit përfitojnë drejtpërdrejt nga efektet anësore si përmirësim i shëndeti në punë dhe i kushteve të sigurisë, por gjithashtu ata kujdesen për mjedisin.

Përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme: Ka dy tipe kryesore presionesh që do të ndryshojnë tregjet e së ardhmes: Së pari, kufizimet e botës natyrore – çështje si ngrohja globale, pamjaftueshmëria e ujit dhe humbja e biodiversitetit- do të ndrydhin veprimet e bizneseve. Së dyti, bizneset përballen me një spektër në rritje të klientëve që janë të shqetësuar për mjedisin. Ato biznese që përballen më mirë dhe që i gjejnë një zgjidhje këtyre sfidave, do të mundin konkurrentët e tyre. Duke rritur ndërgjegjësimin mjedisor brenda organizatës suaj, një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të ndihmojë në zbatimin e hapave të nevojshme si eko-projekti, në mënyrë që të zhvillohen procese dhe produkte që do të jenë të përshtatshme për tregjet e së nesërme, të cilat do të jenë më të ndërgjegjësuara për mjedisin.

Sistemet e Menaxhimit Mjedisor u përdor si bazë për identifikimin dhe analizën e pasojave mjedisore nga ndërtimi dhe operimi i thertores, duke lejuar:

- Identifikimin e aspekteve dhe ndikimeve mjedisore të rëndësishme.
- Hartimin e masave parandaluese dhe korrigjuese për reduktimin e ndikimeve.

- Përgatitjen e një plani veprimi për menaxhimin e aspekteve të identifikuara.

Kjo qasje siguron që ndikimet negative potenciale të kontrollohen në mënyrë efektive dhe që projekti të përmbushë standardet më të larta të menaxhimit mjedisor.

8. PERSHKRIMI I MASAVE

Për të siguruar që ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve të ketë ndikime minimale mbi mjedisin dhe të përmbushë kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare, janë planifikuar një sërë masash parandaluese, korrigjuese dhe kompensuese që adresojnë të gjitha aspektet mjedisore të identifikuara gjatë procesit të vlerësimit. Masat e propozuara përfshijnë kontrolle të integruara teknike, organizative dhe operative që mbulojnë të gjitha fazat e ciklit jetësor të projektit. Gjatë fazës së ndërtimit, do të zbatohen masa për kontrollin e emetimeve të pluhurit dhe zhurmës. Gjatë fazës së operimit, masat kryesore përfshijnë instalimin e sistemeve moderne të ventilimit dhe filtrimit për reduktimin e erërave të pakëndshme dhe emetimeve në ajër, sistemet e brendshme për trajtimin paraprak të ujërave teknologjike përpara shkarkimit në rrjetin publik, si dhe zbatimin e një plani gjithëpërfshirës për menaxhimin e mbetjeve organike dhe joorganike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të reduktuar ndikimet në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të thertores së shpezëve, janë planifikuar masa specifike që synojnë minimizimin e emetimeve të pluhurit, gazeve ndotëse dhe erërave të pakëndshme. Gjatë fazës së ndërtimit, për të kontrolluar emetimin e pluhurit nga punimet gërmuese dhe lëvizja e mjeteve ndërtimore, do të kryhet spërkatja periodike e sipërfaqeve të hapura me ujë, sidomos në ditët e thata dhe me erë. Gjithashtu, do të përdoren mjete dhe pajisje ndërtimore që përmbushin standardet më të fundit të emetimeve (Euro 5 ose më të larta) për të reduktuar emetimet e gazeve si NO_x, CO dhe CO₂. Në fazën e operimit, për të parandaluar përhapjen e erërave të pakëndshme që mund të gjenerohen nga proceset teknologjike dhe menaxhimi i mbetjeve organike, thertorja do të pajiset me sisteme moderne ventilimi dhe biofiltra për trajtimin e ajrit. Gjithashtu, mbeturinat organike do të menaxhohen në kohë reale duke u ruajtur në hapësira të mbyllura dhe të kontrolluara termikisht për të shmangur fermentimin dhe prodhimin e erërave.

Përveç kësaj, do të zbatohet një program monitorimi periodik i cilësisë së ajrit për të siguruar që nivelet e emetimeve të jenë brenda kufijve të lejuar ligjorë dhe për të mundësuar ndërhyrje

të menjëhershme në rast devijimesh. Me zbatimin e këtyre masave, pritet që ndikimet në ajër të reduktohen ndjeshëm dhe të mbahen në nivele të pranueshme për mjedisin dhe komunitetin përreth.

8.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Për të minimizuar ndikimet potenciale në burimet ujore dhe në tokë gjatë ndërtimit dhe operimit të thertores së shpezëve, janë planifikuar masa specifike që synojnë mbrojtjen e këtyre komponentëve mjedisorë nga ndotjet dhe degradimi. Gjatë fazës së ndërtimit, do të ndërmerren masa për parandalimin e rrjedhjeve aksidentale të derivateve të naftës, vajrave dhe substancave të tjera të rrezikshme, përmes ruajtjes së tyre në kontejnerë të mbyllur dhe me baza të papërshkueshme nga uji. Gjithashtu, do të vendosen barriera mbrojtëse për të parandaluar shkarkimin e sedimentit dhe mbetjeve ndërtimore në ujërat përreth.

Në fazën e operimit, për menaxhimin e ujërave të ndotura teknologjike që gjenerohen nga proceset e therjes, pastrimi dhe ftohja, do të implementohet një sistem i trajtimit paraprak të ujërave brenda objektit. Ky sistem do të përfshijë grumbullimin, filtrimin mekanik dhe trajtimin biologjik ose kimik për të siguruar që ujërat e shkarkuara të përmbushin standardet ligjore për cilësinë e ujit. Për të mbrojtur tokën nga ndotjet potenciale, mbeturinat organike dhe lëndët ndihmëse do të depozitohen në sipërfaqe të papërshkueshme dhe të mbyllura, duke parandaluar infiltrimin e substancave të dëmshme në shtresat sipërfaqësore ose nëntokësore të tokës.

Gjithashtu, do të aplikohet një plan për menaxhimin e ujërave të shiut nga sipërfaqet e ndërtuara, duke përfshirë sistemet për grumbullimin dhe trajtimin e tyre për të reduktuar ngarkesën ndotëse para shkarkimit në mjedis. Me zbatimin e këtyre masave, ndikimet negative mbi ujin dhe tokën do të reduktohen ndjeshëm, duke garantuar mbrojtjen e burimeve natyrore dhe përputhjen me standardet mjedisore.




Figura 13 Model Impianti për trajtimin e ujerave te ndotura kapaciteti ditor i trajtimit 30 m³

8.3 Masat për mbrojtje nga zhurma

Për të reduktuar ndikimet negative nga zhurma gjatë ndërtimit dhe operimit të thertores së shpezëve, janë planifikuar një sërë masash teknike dhe organizative që synojnë mbajtjen e niveleve të zhurmës brenda kufijve të lejuar ligjorë dhe shmangien e shqetësimeve për komunitetin përreth. Gjatë fazës së ndërtimit, aktivitetet që prodhojnë zhurmë do të kufizohen brenda orarit të punës të përcaktuar ligjërisht (07:00–19:00), duke shmangur punimet e zhurmshme gjatë orëve të natës dhe ditëve të pushimit. Pajisjet ndërtimore dhe makineritë e rënda që përdoren do të jenë të pajisura me sisteme për zvogëlimin e emetimeve akustike dhe do të mirëmbahen rregullisht për të siguruar funksionimin e tyre në mënyrë të qetë.

Gjatë fazës së operimit, burimet e zhurmës do të adresohen përmes përdorimit të pajisjeve teknologjike me izolim akustik dhe instalimit të sistemit të ventilimit me nivele të reduktuara të zhurmës. Për më tepër, përreth objektit do të ndërtohen barriera akustike dhe do të mbillen rripa të gjelbër që do të veprojnë si amortizues natyral të valëve zanore, duke zvogëluar përhapjen e tyre jashtë kufijve të thertores.

Gjithashtu, do të implementohet një program monitorimi të rregullt të niveleve të zhurmës për të siguruar përputhshmërinë me kufijtë ligjorë dhe për të marrë masa korrigjuese në rast se vërehen devijime. Zbatimi i këtyre masave do të sigurojë që ndikimet akustike të projektit të mbahen në nivele minimale dhe të mos përbëjnë shqetësim për mjedisin dhe popullatën përreth.

Në mënyrë që të sigurohet një mjedis i përshtatshëm për zhvillimin e jetës dhe punës, Komuna ka përcaktuar disa kufizime në për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar efekteve e dëmshme, bezdisjen që shkakton zhurma.

Këto kufizime janë të detyrueshme për të gjitha veprimtaritë përbrenda Komunës, të përcaktuara për secilin shfrytëzim të planifikuar të tokës dhe llojit të vendbanimit.

Lloji i zonimit	Zhurma maksimale e lejuar nga ora 08:00 – 22:00	Zhurma maksimale e lejuar nga ora 22:00 – 08:00
ZKZh-A, Zonë Industriale	90 db(A)	90 dB(A)
ZKZh-B, Zona Urbane 1	60 db(A)	50 dB(A)
ZKZh-C, Zonë Komerciale	55 db(A)	45 dB(A)
ZKZh-D, Zonë Mikse – Banim dhe Komerciale	50 db(A)	40 dB(A)
ZKZh-E, Zonë Banimi	45 db(A)	35 dB(A)
ZKZh-F, Zonë Hekurudhore	100 db(A)	100 dB(A)

1

Tabela 3 Kufizimet e Nivelit të lejuar të Zhurmës sipas Hartes zonale të komunës së Fushe Kosovës

8.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Gjatë fazës së ndërtimit, do të shmanget hapja e sipërfaqeve të panevojshme për të ruajtur bimësinë përreth, ndërsa çdo prerje e pashmangshme e vegjetacionit do të kompensohet me mbjelljen e gjelbërimeve të reja në zonat e caktuara për rehabilitim. Punimet do të planifikohen për të shmangur periudhat e ndjeshme për faunën lokale, veçanërisht për shpendët nëse evidentohen zona të mundshme të folezimit.

Gjatë fazës së operimit, për të ruajtur harmoninë vizuale me mjedisin, projekti parashikon dizajn arkitektonik të përshtatur me zonën industriale dhe mbjelljen e gjelbërimeve përreth perimetrit të objektit. Këto gjelbërime do të veprojnë gjithashtu si barriera natyrore për të reduktuar ndikimet vizuale dhe akustike ndaj zonave përreth.

Me zbatimin e këtyre masave, ndikimet mbi peizazhin, florën dhe faunën konsiderohen minimale dhe të menaxhueshme, duke kontribuar në ruajtjen e vlerave natyrore dhe estetike të zonës përreth.

8.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Për të minimizuar ndikimet mbi vendbanimet dhe popullatën përreth gjatë ndërtimit dhe operimit të thertores së shpezëve, janë planifikuar masa specifike që adresojnë shqetësimet potenciale nga zhurma, trafiku, erërat dhe ndikimet vizuale. Gjatë fazës së ndërtimit, do të

¹ [HartaKomplethZKFK.pdf](#)

kufizohet orari i punimeve në periudhën 07:00–17:00 për të shmangur shqetësimet gjatë orëve të pushimit, dhe do të përdoren pajisje ndërtimore me nivele të ulëta të zhurmës dhe emetimeve. Lëvizja e automjeteve të rënda për transportin e materialeve do të organizohet për të shmangur trafikun e tepërt në rrjetin rrugor lokal, veçanërisht në orët e pikut.

Gjatë fazës së operimit, për të kontrolluar erërat e pakëndshme që mund të shqetësojnë popullatën, do të instalohen sisteme moderne të filtrimit dhe biofiltra në zonat kritike të procesit. Përveç kësaj, mbeturinat organike do të menaxhohen në hapësira të mbyllura dhe do të asgjësohen në kohë reale për të shmangur fermentimin dhe emetimin e aromave të padëshiruara. Zhurma që mund të gjenerohet nga pajisjet teknologjike dhe transporti do të reduktohet përmes përdorimit të pajisjeve me izolim akustik dhe vendosjes së barrierave të gjelbra rreth objektit. Gjithashtu, do të zhvillohet një program komunikimi me komunitetin lokal për informimin e rregullt mbi aktivitetet e thertores dhe për trajtimin në kohë të çdo shqetësimi të mundshëm. Këto masa do të kontribuojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme dhe pozitive me banorët përreth dhe në minimizimin e ndikimeve sociale të projekti.

8.6 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të thertores mund të vlerësohen si raste të izoluar. Për të mos ardhur deri të ndonjë aksidenti eventual investitori i thertores nga kompania “Kosmonte Foods SH.P.K., duhet që të merre masat adekuate, si hartimin e elaboratit kundër zjarrit dhe të paraqes të gjitha zonat e rrezikut paraprakisht. Rreziku më i madhe për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet elektrike të fabrikës.

8.7 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Gërmime, lëvizje e mjeteve ndërtimore, proceset e therjes dhe menaxhimi i mbetjeve organike	Ndotje e ajrit dhe erëra të pakëndshme	Sisteme ventilimi dhe biofiltra, spërkatje me ujë, përdorimi i pajisjeve me standarde të larta
Uji dhe Toka	Shkarkimi i ujërave teknologjike dhe rrjedhjet aksidentale gjatë ndërtimit	Ndotje e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	Sisteme trajtimi paraprak të ujërave, depozitimi në sipërfaqe të papërshkueshme

Toka	Ngjeshja e tokës nga makineritë, depozitimi i mbetjeve organike	Kontaminim i shtresave sipërfaqësore dhe erozion	Menaxhim i mbetjeve në ambiente të mbyllura dhe rehabilitim i zonave të prekura
Biodiversiteti dhe peizazhi	Shpërndarja e mbetjeve, punimet ndërtimore që prekin bimësinë	Humbje e biodiversitetit lokal dhe ndikim vizual	Ruajtje e vegjetacionit ekzistues, mbjellje gjelbërimesh dhe dizajn i përshtatshëm
Popullata dhe vendbanimet	Zhurma, trafiku dhe erërat e pakëndshme	Shqetësime për komunitetin lokal	Planifikimi i trafikut, barriera gjelbër dhe komunikim me komunitetin
Trashëgimia kulturore dhe pasuritë materiale	Punimet që mund të prekin elemente kulturore të paidentifikuara	Rrezik për dëmtim të aseteve të trashëgimisë	Monitorim arkeologjik gjatë ndërtimit dhe njoftim i autoriteteve
Zhurma	Përdorimi i pajisjeve teknologjike dhe transporti i shpeshtë	Rritje e niveleve të zhurmës në zonat përreth	Izolim akustik i pajisjeve dhe barriera zanore
Mbeturinat	Gjenerimi i mbetjeve organike dhe joorganike gjatë operimit	Rrezik për ndotjen e tokës dhe ujit nga deponimi i pakontrolluar	Menaxhim i integruar i mbetjeve, dërgimi për përpunim ose riciklim

8.8 Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është një komponent thelbësor për minimizimin e ndikimeve mjedisore nga ndërtimi dhe operimi i thertores së shpezëve (Pulave). Projekti parashikon një qasje të integruar për trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave, duke siguruar që të gjitha llojet e mbetjeve të menaxhohen sipas parimeve të hierarkisë së mbetjeve: reduktim, ripërdorim, riciklim dhe asgjësim të sigurt.

Gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta inerte si dheu, mbetjet e betonit dhe ambalazhet plastike do të grumbullohen dhe selektohen në vendin e punës për t'u dorëzuar te operatorët e licencuar për trajtim ose riciklim. Për mbeturinat e rrezikshme, si vajrat e përdorura do të zbatohen procedura të veçanta të mbledhjes dhe ruajtjes në kontejnerë të mbyllur dhe të papërshkueshëm nga uji, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë fazës së operimit, mbeturinat kryesore do të përbëhen nga mbetjet organike (gjaku, organet e brendshme, kockat) dhe mbeturinat joorganike (ambalazhet, materiale ndihmëse). Mbetjet organike do të menaxhohen në kohë reale duke u grumbulluar në hapësira të mbyllura dhe të ftohta për të shmangur fermentimin dhe përhapjen e erërave të pakëndshme. Ato do të dërgohen për përpunim të mëtejshëm në impiante të specializuara, përmes kompanive të

specializuara per grumbullimin e tyre

Këto masa synojnë minimizimin e ndikimeve mjedisore të mbetjeve, reduktimin e sasisë së mbeturinave për deponim dhe mbrojtjen e tokës, ajrit dhe ujërave nga ndotja.

Për largimin e këtyre mbeturinave kompania “Kosmonte Foods” SH.P.K., do te beje marrëveshje me kompaninë e cila merret me menaxhimin e mbeturinave nga Komuna e Fushë Kosovës, po ashtu do te bej kontratë edhe me kompani per reciklim te mbeturinave, konkretisht per mbeturinat organike (gjaku, organet e brendshme, pendët).

Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror:

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror te mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e Rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për Deponim te mbeturinave
02 01 02 02 02 02	Mbeturinat nga indet e shtazëve	Jo të rrezikshme	Komore per mbetje shtazore dhe Kontejner për mbeturina
20 01 01	Letër dhe karton	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
20 03 01	Mbeturina te përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Për mbetje e mundshme te këtij aktiviteti, zgjidhja është si ne vijim:

- Mbeturinat e riciklueshme do te grumbullohen dhe do te dërgohen ose do te merren nga kompanitë te cilat merren me riciklim,
- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do te trajtohen komfor legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.

9. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave te mëdha qe lidhen me thertoren per shpezët nga kompania “Kosmonte Foods” SH.P.K., nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund te kemi

vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djegë ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit dhe hidrantë të brendshme për fikjen e zjarrit.

10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe raportimi përbëjnë pjesë integrale të menaxhimit mjedisor të projektit dhe janë thelbësorë për të siguruar që të gjitha aktivitetet ndërtimore dhe operacionale të zhvillohen në përputhje me standardet ligjore dhe objektivat e mbrojtjes së mjedisit. Programi i monitorimit synon të identifikojë në kohë çdo devijim nga parametrat e parashikuar mjedisorë dhe të mundësojë ndërmarrjen e masave korrigjuese për minimizimin e ndikimeve.

Monitorimi do të përfshijë komponentët kryesorë mjedisorë si cilësia e ajrit, ujit, tokës, nivelet e zhurmës dhe menaxhimi i mbetjeve. Për ajrin, do të monitorohen nivelet e pluhurit (PM₁₀ dhe PM_{2.5}) dhe erërat e pakëndshme pranë kufijve të objektit. Për ujin, do të kontrollohen parametrat e ujërave të shkarkuara (pH, BOD, COD, ngarkesa organike) për të siguruar që ato janë brenda kufijve të lejuar ligjorë. Për tokën, do të inspektohen zonat e depozitimit të mbetjeve për të identifikuar çdo ndotje të mundshme, ndërsa për zhurmën do të kryhen matje periodike në kufijtë e pronës për të garantuar përputhjen me standardet akustike.

Raportimi do të kryhet periodikisht, sipas kërkesave të legjislacionit të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Raportet mjedisore do të përfshijnë të dhënat e monitorimit, analizën e trendeve dhe çdo masë korrigjuese të ndërmarrë. Ato do t'u dorëzohen autoriteteve kompetente mjedisore dhe do të shërbejnë gjithashtu si mjet komunikimi me komunitetin dhe palët e interesuara për të siguruar transparencë dhe besueshmëri.

Përveç kësaj, në rast të ndonjë incidenti mjedisor ose devijimi të rëndësishëm nga parametrat e lejuar, do të realizohet raportim i menjëhershëm dhe do të ndërmerren masa emergjente për minimizimin e ndikimeve. Ky mekanizëm sigurie do të garantojë menaxhim të përgjegjshëm dhe parandalim të dëmtimeve potenciale mjedisore.

11. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) ka analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet mjedisore që lidhen me ndërtimin dhe operimin e thertores së shpezëve në Zonën Industriale të Harilaqit, Komuna Fushë Kosovë. Projekti është konceptuar për të siguruar një kapacitet të përpunimit prej 4,000–6,000 shpezësh në ditë, duke synuar të rrisë sigurinë ushqimore në vend dhe të zvogëlojë varësinë nga importi i produkteve të mishit.

Gjatë procesit të vlerësimit janë identifikuar dhe analizuar ndikimet potenciale në komponentët kryesorë mjedisore, përfshirë ajrin, ujërat, tokën, biodiversitetin, peizazhin, trashëgiminë kulturore dhe shëndetin e popullatës. Ndikimet negative janë të lidhura kryesisht me fazën e ndërtimit dhe përfshijnë emetimin e pluhurit dhe gazeve ndotëse, gjenerimin e zhurmës dhe mundësinë për ndotje të ujërave dhe tokës nga rrjedhjet aksidentale. Në fazën e operimit, ndikimet potenciale lidhen me gjenerimin e erërave të pakëndshme, ujërave teknologjike dhe mbeturinave organike, si dhe rritjen e trafikut.

Megjithatë, projekti ka parashikuar një sërë masash parandaluese dhe korrigjuese që garantojnë minimizimin e ndikimeve mjedisore. Këto përfshijnë: instalimin e sistemeve moderne të ventilimit dhe biofiltrave, trajtimin paraprak të ujërave të ndotura përpara shkarkimit në rrjetin publik, menaxhimin e integruar të mbetjeve, izolimin akustik të pajisjeve dhe ndërtimin e barrierave gjelbëruese rreth objektit. Gjithashtu, është planifikuar një program gjithëpërfshirës për monitorimin dhe raportimin periodik të parametrave mjedisore, që do të mundësojë kontrollin e vazhdueshëm dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rast devijimesh.

Në përfundim, me zbatimin e të gjitha masave të propozuara dhe respektimin e legjislacionit përkatës mjedisor, projekti pritet të jetë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit dhe nuk parashikohet të ketë ndikime të pakthyeshme ose të konsiderueshme negative. Përkundrazi, ai ofron përfitime të rëndësishme socio-ekonomike për komunitetin lokal dhe sektorin agro-ushqimor në vend.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësish Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastruktura (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit - aplikuesit “Kosmonte Foods” SH.P.K nga Prishtina.

12. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

kosmonte greenfield 4000 bph (expandable 6000 bph)		Makineri e përdorur
Përmbledhje e çmimit(kostos)	um	
trajtimi i shpendëve të gjallë	set	54,636.60 €
therja dhe heqja e pendëve	set	167,574.60 €
eviscerimi (heqja e organeve të brendshme)	set	337,080.20 €
trajtimi i organeve të brendshme (viscera)	set	48,222.00 €
transporti i nënprodukteve	set	27,806.00 €
ftohja	set	294,733.20 €
prerja në pjesë		118,278.00 €
marrja e të dhënave dhe kontrolli i procesit		50,931.20 €
		1,099,261.80 €
kosto për mbikëqyrjen e instalimit, trajnimin dhe vënien në punë		51,000.00 €
dorëzimi		54,000.00 €
Totali i shumës së makinerive të përdorura		1,204,261.80 €
Kosto investive e ndërtimit:		1,795,738.20 €
Kosto totale e investimit në therretore:		3,000,000.00 €

Kosmonte Foods Sh.p.k.

Harilaq, K. Fushë Kosovë

13. LITERATURA E PERDORUR

Referencat:

Kosmonte Foods Sh.p.k. (n.d.). *Të dhënat nga investitori*.

Kosmonte Foods Sh.p.k. (n.d.). *Projekti konceptual i fabrikës së thertoresh së pulave*.

UN-Habitat Kosovo. (n.d.). *PLVM-Fush-kosova1: Layout 1.qxd*. Marrë nga <https://unhabitat-kosovo.org>

Komuna e Fushë-Kosovës. (2020). *Harta zonale e Komunës së Fushë-Kosovës 2020–2028*.

Republika e Kosovës – Qeveria. (n.d.). *Kërko dhe paraqit – KGP*. Marrë nga <https://rks-gov.net>

OpenStreetMap. (n.d.). *OpenStreetMap*. Marrë nga <https://www.openstreetmap.org>

Kosmonte Foods Sh.p.k. (n.d.). *Faqja zyrtare*. Marrë nga <https://ks.kosmontefoods.com>

Republika e Kosovës. (2024). *Ligji nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis*. Marrë nga <https://rks-gov.net>

